



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

Numri i lëndës: 2019:264956
Datë: 24.05.2022
Numri i dokumentit: 03047610

C.nr.914/2019

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË – Departamenti i përgjithshëm – Divizioni civil, me gjyqtar Mirjeta Shala , në çështjen juridiko- kontestimore të paditësit, Xh.G., A.X., A.S., R.Ll., A.K., D.L., Xh.Gj., B.K., S.B., A.A., Z.I., Sh.P., A.Gj., I.G., P.R., A.M., G.S., A.O., R.R., J.L., K.L., Y.R., E.P., B.Zh., B.L., N.L., B.B., Xh.B., S.R., F.B., B.K., M.K., B.G., I.R., A.F., B.B., A.D., L.B., A.A., A.H., S.A., F.D., F.N., L.Gj., K.Ll., dhe M.X., të cilët sipas autorizimit i përfaqëso Sabrije Sylta, avokate në Suharekë, kundër të paditurit, Ministria e Punëve të Brendshme -Agjencia e Menagjimit Emergjent, me për kompensimin e te ardhurave personale , me datë 24.05.2022, mori këtë:

A K T V E N D I M

I. Paditësve, Xh.G., A.X., A.S., R.Ll., A.K., D.L., Xh.Gj., B.K., S.B., A.A., Z.I., Sh.P., A.Gj., I.G., P.R., A.M., G.S., A.O., R.R., J.L., K.L., Y.R., E.P., B.Zh., B.L., N.L., B.B., Xh..B., S.R., F.B., B.K., M.K., B.G., I.R., A.F., B.B., A.D., L.B., A.A., A.H., S.A., F.D., F.N., L.Gj., K. Ll., dhe M.X., , i’u KTHEHET në plotësim padia e datës 14.11.2019, ashtu që detyrohen paditësit, që në afat prej 3 ditësh nga dita e marrjes së këtij aktvendimi, ti dorëzoj provat e padisë, në kopje të mjaftuara për të paditurën si dhe të bëjë plotësimin e padisë sa i përket subjektivitetit juridik të palës së paditur në këtë procedurë, në mënyrë që gjykata të mund të veproj si

II. Do të konsiderohet e tërhequr padia po që se nuk i kthehet gjykatës brenda afatit ligjor, e në qoftë se kthehet e pa korigjuar, gjegjësisht e pa plotësuar do të hedhet poshtë padia.

A r s y e t i m

Paditësit përmes të autorizuarës së tyre, Av. Sabrije Sylja, nga Suhareka, kanë ushtruar padi në këtë gjykatë me datë 14.11.2019, dhe parashtrësën për precizim të datës 21.12.2021, kundër të paditurës Ministria e Punëve të Brendshme -Agjencia e Menagjimit Emergjent, me objekt kontesti kompensimin e të ardhurave personale.

Gjykata me aktvendimin C.nr.914/2019 të datës 13.10.2020 i ka obliguar paditësit që të bëjnë rregullimi kërkesëpadiisë, në atë mënyrë që të bëjë precizimin detal të kërkesëpadiisë veç e veç për secilin paditës veç e veç si të specifikoj në mënyrë të veçantë legjitimitetin pasiv të paditurës.

E autorizuara e paditësve me parashtrësën e datës 19.10.2020 ka specifikuar kërkesëpadiinë për secilin paditës veç e veç si dhe si të paditu e ka cekur ***Drejtoria Komunale për Mbrojtje dhe Shpëtim.***

E njëjta me parashtrësën e datës 21.12.2021, si të paditur e ka cekur ***Komunën e Gjakovës.*** Po ashtu në këtë parashtrësë e njëjta e ka bere zgjerimi e padiisë edhe në aspektin subjektiv dhe objektiv, edhe për disa paditës të tjerë si dhe ka dorëzuar prova për paditësit.

Në nenin 78 paragrafi 1 të Ligjit të Procedurës Kontestimore, i cili parasheh se *“Kur gjykata konstaton se personi që paraqitet si palë nuk mund të jetë palë në procedurë, dhe se kjo mungesë mund të evitohet, do ta ftojë paditësin që të bëjë ndreqje të nevojshme në padinë ose do të ndër marrë masa të tjera me qëllim që procedura të mund të vazhdohet me personin që mund të jetë palë në procedure”*, paditëse i kthehet në plotësim padia, duke e obliguar që të veproj në afatin ligjor të cekur sikurse në pikën I të këtij aktvendimi dhe të përcaktojë sakte se kush është palë e paditur.

Në anën tjetër në 100 të LPK-së është paraparë që *“Parashtrësat, dhe shkresat që i bashkëngjiten atyre, që duhet t’i dërgohen palës kundërshtare i dorëzohen gjykatës në numër të mjaftueshëm ekzemplarësh për gjykatën dhe palën kundërshtare”*. Gjykata gjatë shqyrtimit paraprak të padiisë dhe parashtrësës së datës 21.12.2021, gjeti se të njëjtës i mungojnë kopjet e mjaftuara të provave për palën e paditure, ashtu që nuk i plotëson kushtet në kuptim të dispozitës së nenit 100 të LPK-së, që të veproj sipas saj, ashtu që gjykata vendosi si në pikën I të dispozitivit të këtij aktvendimi, duke i dorëzuar kopjet e mjaftueshme për gjykatën dhe palët në procedurë.

Gjykata vendosi sikurse në pikën II të dispozitivit të këtij aktvendimit, ashtu që në rast së paditësi nuk vepron sipas afatit të përcaktuar në pikën I të dispozitivit do të konsiderohet se është tërhequr padia, ndërsa në qoftë së kthehet pa u korrigjuar, gjegjësisht pa u plotësuar, do të hedhet poshtë si e palejuar.

Meqenëse gjykata nuk ka mundësi të veproj sipas padisë, në kuptim të dispozitave nga neni 78 paragrafi 1, 99 paragrafi 2, dhe nenit 102 të Ligjit të Procedurës Kontestimore, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË –

Departamenti i Përgjithshëm

C.nr.914/2019, date 24 maj 2022

**Gjyqtarja
Mirjeta Shala**

KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktvendimi nuk është e lejuar ankesa